AKIV

RIINTEGRIMI SUBSTANCIAL

si të shmanget 'Qeverisja Zombi' në veri të Kosovës



MITROVICË
MAJ 2025

RIINTEGRIMI SUBSTANCIAL
si të shmanget 'Qeverisja Zombi' në veri të Kosovës

Botues:
OJQ AKTIV
Adresa:
Kralja Petra I, 183a, Mitrovica e Veriut
Qamil Hoxha 38/1, Prishtinë
Kosovska 17/3, Beograd

Redaktor:
Miodrag Miliçeviq

Dizajni:
Darija Viro

Mitrovicë, Maj 2025

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare nga UNMIK-u në kuadër të projektit "Mbështetje e mëtutjeshme për qasje në drejtësi dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Mitrovicës". Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OJQ Aktiv dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNMIK-ut.

PËRMBAJTJA

5 / Hyrje

9 / Forcimi i qasjeve të bazuara në komunitet ndaj sigurisë dhe mbrojtjes

13 / Zvogëlimi i pikave të verbëra të ofrimit të shërbimeve komunale

15 / Mjedis i favorshëm për sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mirë në veri të Kosovës

17 / Përfundime dhe rekomandime

HYRJE

Situata e sigurisë dhe pushtetit lokal në veri të Kosovës për rreth tre vite është përballur me sfida të thella, duke zhbërë kështu pjesën më të madhe të progresit të arritur gjatë dekadës së fundit në aspektin e integrimit të serbëve të Kosovës dhe duke tensionuar marrëdhëniet midis komuniteteve të ndryshme. Këto sfida u shfaqën para sulmit në Banjskë në shtator të vitit 2023, e që atëherë janë bërë edhe më akute. Situata në veri më pas ka bllokuar dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, duke i tensionuar edhe më tej marrëdhëniet dhe duke ngritur shqetësime për zhvillime të mëtejshme negative në veri të Kosovës.

Në prill të vitit 2023, zgjedhjet lokale në katër komunat me shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) u bojkotuan nga popullsia etnike serbe, duke rezultuar me pjesëmarrje jashtëzakonisht të ulët të votuesve[1]. Në zgjedhje kanë dalë vetëm rreth 3.47% e votuesve, ndërsa pjesëmarrja e serbëve të Kosovës ka qenë minimale.[2] Kjo çoi në zgjedhjen e kryetarëve të komunave me origjinë shqiptare, të cilëve u mungon legjitimiteti në sytë e komunitetit lokal serb. Ky rezultat për këto komuna nuk ofroi zgjidhje politike afatgjate. Situata u përshkallëzua më tej në maj të vitit 2023, kur Qeveria e Kosovës, pavarësisht paralajmërimeve nga bashkësia ndërkombëtare, përdori forcën gjatë hyrjes në ndërtesat komunale për t'u mundësuar kryetarëve të rinj të zgjedhur që të marrin detyrën[3]. Ky veprim shkaktoi tensione serioze dhe përplasje të dhunshme në terren.

Vendosja e kryetarëve të komunave të perceptuar si autsajder thelloi përçarjet midis serbëve vendas dhe institucioneve të Kosovës, duke e bërë qeverisjen komunale në adresimin e nevojave të komunitetit joefektive. Pakënaqësitë në secilën prej katër komunave janë të përhapura, dhe shumë prej tyre pohojnë se qeveritë aktuale lokale në thelb janë jofunksionale. Megjithatë, pavarësisht skenarëve të ndryshëm që parashikuan zgjedhje të parakohshme lokale në veri ato nuk u materializuan.

Erozioni i besimit që pasoi ndikoi thellësisht në të gjitha aspektet e jetës në veri të Kosovës, përfshirë situatën e sigurisë dhe mbrojtjen e të drejtave themelore, duke prekur jo vetëm komunitetin serb të Kosovës, por edhe të tjerët që banojnë në veri. Ekziston një ndjenjë e dukshme pasigurie që mbizotëron në mesin e popullatës lokale serbe. Organizatat e shoqërisë civile dhe mediat lokale raportojnë një trend shqetësues të rritjes së ngacmimit të grave dhe vajzave në veri të Kosovës, duke përfshirë ngacmimin seksual, dhe mungesën e përgjigjeve institucionale, veçanërisht nga Policia e Kosovës (përfshirë dështimin për t'iu përgjigjur raportimeve dhe presionit mbi dëshmitarë) dhe Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK).

[1] https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-izbori-srpska-lista/32373784.html

[2] https://www.danas.rs/vesti/politika/cik-na-izborima-u-opstinama-na-severu-kosova-glasalo-3-47-odsto-upisanih-biraca/

[3] https://kossev.info/violence-ensues-as-special-police-forcibly-enter-municipal-buildings/

Kjo situatë u komplikua edhe më tej nga veprimet e shpeshta të njëanshme të Qeverisë së Kosovës, të tilla si mbyllja e institucioneve në veri dhe gjetiu, duke mos përfillur detyrimet e saj sipas Marrëveshjes së Brukselit për të krijuar Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me shumicë serbe. Banorët e katër komunave veriore kanë ngelur në një gjendje paqartësie, dhe kryetarët e komunave dhe këshilltarët komunalë që morën detyrën nuk kanë gëzuar mbështetjen e popullsisë lokale të cilës ishin të mandatuar t'i shërbenin. Përderisa vendimet janë zbatuar në përputhje me ligjet dhe kornizën kushtetuese të Kosovës, ato në masë të madhe janë refuzuar nga komuniteti serb i Kosovës. Të gjitha mekanizmat për konsultim janë shkatërruar, që do të thotë se zërat e atyre që preken më shumë nga miratimi i tyre nuk po dëgjohen.

Me zgjedhjet lokale që do të mbahen në Kosovë këtë vjeshtë, perspektivat për kthimin e serbëve të Kosovës në strukturat politike dhe institucionale në veri të Kosovës janë gjithnjë e më të prekshme, edhe pse pengesat e mundshme që mund të pengojnë emërimin e kandidatëve dhe pjesëmarrjen e votuesve mbeten. Zgjedhjet e rregullta lokale mund t'i japin fund një periudhe të definuar me mosangazhim të komunitetit serb të Kosovës që nga dorëheqjet masive të nëntorit 2022.

Nëse gjithë kjo do hap rrugën për riintegrimin e policëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve të komunitetit serb të Kosovës është përtej fushëveprimit të këtij dokumenti. Megjithatë, është një moment i duhur për të shqyrtuar natyrën e sigurisë së komunitetit dhe qeverisjes lokale që mund të shfaqen pas këtyre zgjedhjeve, si dhe modelet e mundshme të angazhimit qytetar që mund të plotësojnë qeverisjen në veri të Kosovës. Ndërsa ka të ngjarë që zyrtarët e zgjedhur dhe punonjësit komunalë nga komuniteti serb i Kosovës të rimarrin postet e tyre në strukturat komunale, mbetet për t'u parë se deri në çfarë mase kjo përbën një hap thelbësor drejt vendosjes së qeverisjes së përgjegjshme në veri të Kosovës.

Ekzistojnë shqetësime të thella në lidhje me shfaqjen e mundshme të asaj që mund të quhet "Qeverisje Zombi"; domethënë, qeveritë komunale që formalisht ekzistojnë dhe funksionojnë minimalisht, por që në fakt janë jofunksionale për shkak të mungesës së vizionit dhe kapacitetit, duke i bërë të paafta në miratimin e politikave kuptimplote që i përgjigjen nevojave dhe shqetësimeve të banorëve vendas. Ndërkohë që qeveri të tilla do të gëzonin legjitimitet më të gjerë elektoral, të dhuruara nga komuniteti serb i Kosovës përmes kutive të votimit, ato nuk do të përmbushnin standardet e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe ofrimit të shërbimeve që mbështesin qeverisjen e suksesshme lokale.

Përhapja e të ashtuquajturit "qeverisje zombi", pra pushtetit lokal jofunksional, do t'i forconte edhe më tej trendet negative në qeverisje në veri të Kosovës, veçanërisht pas pakënaqësisë së theksuar disavjeçare në mesin e qytetarëve. Analiza e Trendeve e realizuar nga Aktivi për vitin 2024 tregon pa dyshim " pakënaqësi dhe pesimizëm të thellë të komunitetit serb në Kosovë"[4]. Për më tepër, anketa rregullisht ka nxjerrë në pah nivele të ulëta të besimit të serbëve të Kosovës në "komunat në sistemin e Kosovës në zonat me shumicë serbe".

[4] https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2025/04/Analiza-Trendova-2024-1.pdf

Për të zbutur rrezikun e shfaqjes së një qeverisjeje të tillë, ky punim bën thirrje për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj pushtetit lokal dhe sigurisë/mbrojtjes së komunitetit që shkon vetëm përtej kthimit formal të serbëve të sapozgjedhur të Kosovës dhe stafit administrativ. Për të zbutur rreziqet e përshkruara më parë, duhet të ndiqen partneritete efektive midis qeverive lokale të sapokrijuara dhe shoqërisë civile në sferat e sigurisë/mbrojtjes së komunitetit dhe ofrimit të shërbimeve sociale në veri. Modele të tilla do t'i ndihmojnë qeveritë lokale të kuptojnë më mirë nevojat dhe shqetësimet e të gjithë banorëve vendas, duke kontribuar kështu në ofrimin e shërbimeve më efikase dhe efektive. Përveç kësaj, krijimi i kanaleve të tilla të komunikimit është çelës për rindërtimin e besimit midis shoqërisë civile dhe pushtetit lokal pas prishjes së marrëdhënieve në vitet e fundit.

Në të njëjtën kohë, duhet të ndërmerren hapa themelorë për të përmirësuar mjedisin e favorshëm për një qeverisje lokale efektive në veri të Kosovës. Për shembull, bojkoti i regjistrimit të popullsisë në veri do të ketë pasoja buxhetore që ndikojnë rëndë në ofrimin e shërbimeve. Për më tepër, Fondi për Zhvillim, i cili u krijua për të siguruar investime për veriun, për disa vite është në prag të shuarjes. Të dyja këto çështje, së bashku me shqyrtimin e kufijve midis Mitrovicës së Veriut dhe Jugut, duhet të adresohen pa vonesë të mëtejshme në mënyrë që të krijohet një mjedis në veri ku qeverisja lokale mund të lulëzojë.

FORCIMI I QASJEVE TË BAZUARA NË KOMUNITET NDAJ SIGURISË DHE MBROJTJES

Trendet kryesore nga perspektiva e sigurisë për vitin 2024 tregojnë se mesatarisht "çdo i pesti serb i anketuar konsideron se siguria e tij ishte kërcënuar gjatë vitit që lamë pas". Metodat e policimit që konsiderohen represive kanë kontribuar në përkeqësimin e situatës së sigurisë, me shumë të rinj që e shohin gjithnjë e më shumë Policinë e Kosovës si armiq de facto, në vend që të jenë të përgjegjshëm ndaj komuniteteve për të cilat janë caktuar të shërbejnë. Nocioni i policimit me pëlqim është shpërbërë pothuajse tërësisht. Përderisa Kosova ka vendosur njësi speciale të policisë në veri, prania e tyre e rëndë është parë si lloj provokimi nga serbët vendas të Kosovës. Ka pasur akuza të përsëritura për abuzim verbal dhe fizik gjatë dy viteve të fundit ose edhe më shumë. Frekuenca dhe vazhdimësia e këtyre incidenteve tregojnë për një problem sistemik dhe një dështim të strukturave të sigurisë.

Kjo situatë është ndjerë më shumë nga gratë dhe vajzat në veri të Kosovës, të cilat kanë qenë viktima të ngacmimit nga civilë që vijnë nga pjesa jugore e Mitrovicës, duke përfshirë rastet ku viktimat janë të mitura. Raporti i vitit 2024 i hartuar nga Aktiv (që më pas krijoi një linjë telefonike të dedikuar për viktimat që të raportojnë në mënyrë konfidenciale) theksoi se një grup joformal grash mblodhi në një ditë të vetme nga gra dhe vajza serbe të moshës 15 deri në 60 vjeç viktima të ngacëmimit 30 dëshmi. Këto incidente përfshijnë fyerje dhe ngacmim verbal, pastaj komente të shpeshta seksiste, komente mbi pamjen dhe ngacmime të tjera verbale në hapësira publike, si dhe inçizimin dhe fotografimin e bërë pa pëlqim. Më seriozisht, janë raportuar raste të ngacmimit fizik, duke përfshirë prekje të padëshiruara, përqafime ose ndjekje të vazhdueshme, në mesin e tyre edhe automjete që ju vihen pas grave, duke shkaktuar frikë dhe ankth.

Organizata të ndryshme të shoqërisë civile kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me reagimin joadekuat të Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit të Policisë së Kosovës (IPK). Viktimat shpesh hezitojnë të raportojnë rastet për shkak të mosbesimit në rritje në aftësinë dhe/ose gatishmërinë e Policisë së Kosovës për të hetuar seriozisht raste të tilla. Ndërkohë, IPK ka treguar vetëm rezultate të kufizuara me masat disiplinore për raste të tilla. Mekanizmat për mbikëqyrjen civile të policimit konsiderohen jashtëzakonisht të kufizuar.

Gjithashtu, ka pasur humbje të besimit në aftësinë e misioneve ndërkombëtare, veçanërisht të Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX), për të ofruar mbikëqyrje dhe llogaridhënie të mjaftueshme. Një konsorcium organizatash të shoqërisë civile nga veriu i Kosovës së fundmi e pyeti EULEX-in lidhur me konkluzionet e vlerësimeve të monitorimit të tij, hapat konkretë të ndërmarrë për dështimet sistematike të identifikuara, si dhe si mund të sigurojë që gjetjet dhe rekomandimet e tij të çojnë në ndryshime në sjelljen e strukturave policore. Megjithatë, këto kërkesa në masë të madhe kanë mbetur pa përgjigje, si në nivelin operativ, ashtu edhe në atë diplomatik, duke e thelluar më tej ndjenjën e pasivitetit institucional dhe mungesës së përgjegjësisë për krizën e zgjatur në veri të Kosovës.

Spekulimet e herëpashershme rreth rihapjes së mundshme të Urës Kryesore në Mitrovicë për trafikun e automjeteve kanë nxitur tensione të mëtejshme dhe argumente se mjedisi i sigurisë nuk është i favorshëm për një hap të tillë. Në mungesë të ndërmjetësimit të ripërtërirë të BE-së për këtë çështje, duke përfshirë hezitimin për të sqaruar publikisht se cilat parakushte duhet të përmbushen përpara se Ura të mund të rihapet (përkatësisht, përcaktimi i kufijve komunalë midis Mitrovicës së Veriut dhe asaj të Jugut), konteksti i sigurisë tashmë i brishtë vazhdon të minohet edhe më tej.

Besimi ndërmjet policisë dhe komuniteteve lokale në veri të Kosovës ka gjasa të jetë në nivelin më të ulët që nga integrimi formal i pjesëtarëve të komunitetit serb në institucionet e Kosovës, gjë që ka pasoja serioze për zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në atë rajon[5]. Sfidat e akumuluara dhe ato që lidhen me to sugjerojnë se kjo dinamikë mund të transformohet vetëm përmes një pune transparente, të përgjegjshme dhe efektive nga akterët vendas dhe ndërkombëtarë. Siç thuhej në njoftimin për shtyp të lartpërmendur, "ekziston një nevojë urgjente për të ndërtuar besimin e njerëzve në komunitetin e sigurisë", duke shtuar se, "kjo mund të arrihet vetëm përmes punës së përgjegjshme dhe transparente të të gjitha autoriteteve kompetente, përfshirë misionet ndërkombëtare që kanë një rol të mandatuar në sigurimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë [6]".

Edhe nëse gjendet një rrugë për riintegrimin e zyrtarëve policorë të komunitet serb në Kosovë që më parë kanë dhënë dorëheqjen nga postet e tyre, riparimi i dëmit të shkaktuar do të kërkojë një qasje më holistike ndaj çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes. Duke pasur parasysh një kontekst të tillë, është e nevojshme të merret në konsideratë se si akterët e sigurisë mund të jenë më të përgjegjshëm ndaj nevojave dhe shqetësimeve të komuniteteve lokale, edhe përmes strukturave dhe qasjeve të policimit në komunitet.

Për këtë qëllim, është i domosdoshëm riaktivizimi i Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP) përmes angazhimit aktiv të qeverive lokale të sapokrijuara, me mbështetje të prekshme nga bashkësia ndërkombëtare. Forcimi i KKSB-ve në veri të Kosovës kërkon një qasje shumëplanëshe që rrit kapacitetin, përfshirjen dhe efektivitetin e tyre në nxitjen e bashkëpunimit komunitet-polici.

Si hap i parë, për të adresuar shqetësime specifike të sigurisë është e nevojshme të zgjerohet përfaqësimi në KLSP-të me përfshirjen e anëtarëve të ndryshëm të komunitetit, veçanërisht të grave dhe pjesëtarëve të grupeve tjera të nën-përfaqësuara. Kjo mund të arrihet përmes fushatave proaktive ndërgjegjësuese, edukimit të qytetarëve rreth rolit të KLSP-ve dhe sigurimit të respektimit të të drejtave gjuhësore të të gjithëve gjatë gjithë këtij procesi.

Anëtarët e KLSP-ve duhet të kenë qasje në programe të rregullta trajnimi, përfshirë policimin në komunitet, ndjeshmërinë ndaj konflikteve dhe aftësitë e komunikimit. Duhet të ketë një theks të veçantë në fusha të tilla si krimet e urrejtjes dhe dhuna në familje/me

[5] https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2025/04/Analiza-Trendova-2024-1.pdf

[6] https://ngoaktiv.org/en/news/press-release-5/

bazë gjinore. Gjithashtu, KLSP-ve duhet t'u sigurohet financimi në mënyrë që ato të mund të ndjekin iniciativa të synuara që zgjidhin sfidat e përditshme të sigurisë/mbrojtjes në komunitet në veri të Kosovës.

Lidhur me KKSB-të, udhëheqësitë përkatëse komunale duhet të angazhohen dhe të kenë një rol më aktiv në funksionimin e këtyre organeve për t'u dhënë atyre legjitimitet dhe ndikim më të madh. Në vitet e fundit çështja e sigurisë ka qenë në krye të shqetësimeve të komunitetit serb të Kosovës, prandaj, kërkohet një udhëheqje politike më e vendosur për të angazhuar Policinë e Kosovës për identifikimin dhe adresimin e prioriteteve kryesore.

Një qasje proaktive dhe e orientuar në komunitet ndaj sigurisë mund të ndihmojë në zbutjen e tensioneve rreth çështjeve specifike përpara se ato të përshkallëzohen, veçanërisht duke pasur parasysh mosbesimin ekzistues ndaj Policisë së Kosovës. Në vend të një modeli nga lart poshtë, të fokusuar në zbatimin e ligjit, i cili ka çuar në akuza për metoda represive dhe mosbesim, përparësi ndërtimit të marrëdhënieve dhe nxitjes së besimit i jep një qasje e orientuar nga komuniteti. Kjo arrihet përmes angazhimit dhe dialogut të rregullt brenda dhe midis udhëheqësive komunale, policisë dhe komuniteteve lokale, veçanërisht grupeve të margjinalizuara.

Qasje të tilla mbështesin gjithashtu transparencën dhe llogaridhënien në nivel lokal, duke siguruar që ankesat të hetohen në mënyrë më të hapur e më të detajuar. Ato gjithashtu mbështesin masat parandaluese që mund të zvogëlojnë shqetësimet në lidhje me ngacmimet e policisë, veçanërisht të grave dhe vajzave, duke siguruar një qasje të përqendruar te viktima për të siguruar që rastet të trajtohen me ndjeshmëri dhe profesionalizëm. Së fundmi, ato kontribuojnë në paralajmërimin e hershëm dhe shpërndarjen e informacionit, duke u lejuar udhëheqësve të komunitetit dhe policisë të veprojnë para se situatat të përshkallëzohen. Duke vepruar kështu, ato kontribuojnë në ndryshimin e perceptimeve aktuale negative për policimin në veri të Kosovës.

KAPËRCIMI I MANGËSIVE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNAL

Shkëputja e lidhjeve mes autoriteteve komunale dhe aktorëve kryesorë civilë ka tensionuar marrëdhëniet në katër komunat veriore. Komunat përkatëse në përgjithësi funksionuan pa marrë parasysh nevojat dhe shqetësimet e komunitetit vendor, duke çuar në politika që e kanë tensionuar edhe më shumë mjedisin politik tashmë të paqëndrueshëm. Shumë serbë të Kosovës ndihen më të margjinalizuar se kurrë që nga Marrëveshja e Brukselit në vitin 2011, ku shumë prej tyre theksojnë këtë si faktor kyç (së bashku me konsideratat ekonomike dhe të sigurisë) që qëndron pas vendimit të tyre për t'u larguar tërësisht nga Kosova ose për të marrë në konsideratë një veprimin të tillë[7].

Kjo situatë është komplikuar më tej nga lëvizjet e njëanshme të Prishtinës për mbylljen e institucioneve në veri të Kosovës, që kanë pasur pasoja të konsiderueshme negative në ofrimin e shërbimeve për komunitetin serb të Kosovës. Me ndërprerjen e shërbimeve financiare dhe përfitimeve sociale, ndër të tjera, veprimet e Bankës Qendrore të Kosovës kundër dinarit[8] serb kanë ndikuar shumë në kushtet e jetesës, me ç'rast shumë serbë u detyruan të përshkojnë qindra kilometra për të marrë pagat, pensionet dhe përfitimet sociale. Qendrat për Punë Sociale, të cilat ofronin ndihmë për familjet në nevojë, janë zhvendosur, duke lënë shumë përfitues pa burimin e tyre kryesor të mbështetjes[9].

Për t'iu kundërvënë kësaj ndjenje përjashtimi dhe margjinalizimi, është e domosdoshme të merren në konsideratë modele që kontribuojnë në ndërtimin e partneriteteve thelbësore midis qeverive lokale dhe akterëve të shoqërisë civile, veçanërisht atyre të përfshirë në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet e margjinalizuara. OJQ Aktiv ka zbatuar më herët një proces të planifikimit partcipues të shërbimeve sociale (Participatory Social Services Planning – PSSP) në komunën e Leposaviqit, në bashkëpunim me organizatat People in Need (PIN) dhe Peaceful Change initiative (PCi). Kjo nismë është realizuar në kuadër të projektit "Fuqizimi i zërave lokalë për zhvillim të drejtë" (ALVED), i cili është financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar[10].

Metodologjia e PSSP-së përfshiu themelimin e një Grupi Këshillimor (GK) në Leposaviq, të përbërë nga organizata lokale të shoqërisë civile dhe përfaqësues të komunës, i cili funksiononte në bazë të Memorandumit për Mirëkuptim të nënshkruar me komunën. Grupi Këshillimor hartoi strategjinë komunale për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe familjare, të shoqëruar me plan veprimi të miratuar nga Kuvendi Komunal.

[7] https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2025/04/Trend-Analisis-2024-1.pdf
[8] https://www.kosovo-online.com/vesti/ekonomija/centralna-banka-od-1-februara-evro-jedina-valuta-na-kosovu-za-gotovinske
[9] https://alternativna.com/zatvoreni-centri-za-socijalni-rad-na-severu-kosova-koji-su-funkcionisali-po-sistemu-republike-srbije/
[10] https://ngoaktiv.org/en/news/completed-process-of-participatory-planning-of-social-services/

Kjo strategji u bazua në një proces gjithëpërfshirës të hartëzimit brenda komunitetit lokal, duke u mbështetur në të dhënat e anketave, grupet e fokusit dhe burime të tjera për të kuptuar më mirë nevojat dhe shqetësimet specifike të grupeve dhe individëve specifikë.

Si rezultat i këtij procesi, janë dhënë grante për Shërbime të përkohshme Këshillimore për të Rinj dhe është zhvilluar një iniciativë e fokusuar në vështirësitë socio-ekonomike të grupeve shoqërore të cenueshme. Shoqata "Podrži me" ("Më mbështes") ka arritur të nxisë me sukses të rinj me aftësi të kufizuara nga e gjithë komuna Leposaviq[11], duke përfshirë edhe shumë fshatra të saj me lidhje të dobëta. Aktivitetet përfshinin punëtori kreative për të përmirësuar aftësi të ndryshme motorike dhe aktivitete sportive për të rritur koordinimin fizik. Këto aktivitete gjithashtu nxitën miqësitë midis pjesëmarrësve dhe ngritën reputacionin e organizatës, duke i mundësuar asaj që të avokojë më mirë për zgjidhje afatgjata. Gjithashtu, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfituan këshillime dhe takime me grupin mbështetës mbi tema si menaxhimi i sjelljes, integrimi në shkollë dhe aftësitë jetësore.

Për më tepër, Aktiv mbështeti organizatat e shoqërisë civile me bazë në komunitet në përmirësimin e kapaciteteve të tyre për përmbushjen e kërkesave kontraktuale, duke përfshirë raportimin financiar e narrativ dhe prokurimin. Projekti gjithashtu mundësoi komunikim më të mirë të informacionit në lidhje me COVID-19 tek banorët vendas dhe kontribuoi në zbatimin më të mirë të masave mbrojtëse. Fushata publike ofroi informacion mbi virusin, masat mbrojtëse dhe hodhi poshtë konceptet e gabuara[12].

Ky proces ofron një qasje bashkëpunuese për hartimin dhe zbatimin e qasjeve të përshtatura sipas nevojave të komuniteteve lokale, me një shumicë të banorëve që besojnë se qeveria lokale ishte bërë më e përgjegjshme ndaj nevojave të tyre specifike. Replikimi i metodologjive të tilla, të përshtatura sipas realiteteve specifike të secilës komunë, mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit në mesin e komunitetit serb të Kosovës lidhur me të drejtat dhe përfitimet e tyre, duke ndërtuar ndërkohë mekanizma që përmirësojnë ofrimin e shërbimeve në nivel komunal.

Në një kontekst të tillë, një qasje pjesëmarrëse mund të sigurojë që çështjet e margjinalizuara - të tilla si ato që prekin të rinjtë, të moshuarit dhe ata në zonat rurale, ndër të tjera - të vihen në vëmendjen e autoriteteve lokale. Nuk është dhe nuk mund të jetë një zëvendësim për strukturat institucionale të targetuara në mënyrë të njëanshme nga Prishtina, me ndikim negativ të konsiderueshëm dhe të gjerë tek serbët e Kosovës. Mbyllja e tyre ka çuar në sfida të ndryshme duke çrregulluar mirëqenien sociale, kujdesin shëndetësor, pensionet, punësimin dhe shërbimet bankare/financiare. Meqenëse bashkësia ndërkombëtare ka qenë e zëshme në kritikat e saj ndaj veprimeve të Prishtinës, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e alternativave të qëndrueshme për shërbimet e ofruara më parë nga institucionet serbe, statusi i strukturave të mbështetura nga Serbia duhet të zgjidhet përmes negociatave, e jo mbylljeve të njëanshme.

[11] https://westernbalkans.peopleinneed.net/media/publications/1882/file/brochure-alved-grant_kosovo—serbia-eng_web.pdf pg.8

[12] https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/01/Covid-19_Izmedju-stvarnosti-i-dezinformacija.pdf

MJEDIS I FAVORSHËM PËR SUNDIMIN E LIGJIT, TË DREJTAT E NJERIUT DHE QEVERISJEN E MIRË NË VERI TË KOSOVËS

Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme të merret në konsideratë mjedisi në të cilin vepron pushteti lokal në veri të Kosovës. Për këtë qëllim, bashkësia ndërkombëtare duhet të demonstrojë angazhimin e saj për një mjedis të favorshëm për sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mirë në veri të Kosovës, duke përfshirë:

1 Mbështetjen për përsëritjen e elementëve specifike të procesit të regjistrimit të popullsisë në veri me qëllim të llogaritjes më të saktë të shifrave të popullsisë.

2 Zhbllokimin e Fondit të Zhvillimit për Veriun e Kosovës, me qëllim mundësimin e investimeve shtesë në shërbimet publike, infrastrukturë dhe zhvillim lokal.

3 Përcaktimi i qartë i kompetencave komunale ndërmjet Mitrovicës së Veriut dhe asaj të Jugut, me qëllim zgjidhjen e paqartësive institucionale dhe përmirësimin e qeverisjes lokale.

Rivitalizimi i Fondit për Zhvillimin e Veriut të Kosovës

Fondi për Zhvillimin e Veriut të Kosovës, i themeluar si pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja midis Beogradit dhe Prishtinës, u krijua për të mbështetur zhvillimin socio-ekonomik të katër komunave në veri të Kosovës[13]. Fondi ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët duke investuar në infrastrukturë (rrugë, furnizim me ujë, etj.), shërbime sociale, ngritje të kapaciteteve institucionale, zbutjen e varfërisë, kulturë, sport dhe bujqësi. Duke financuar projekte që krijojnë vende pune, rrisin të ardhurat dhe përmirësojnë konkurrencën, Fondi, duke luajtur një rol në integrimin e këtyre komunave në kornizën më të gjerë ligjore dhe institucionale të Kosovës, ka ndikuar dhe mund të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të veriut të Kosovës.

Megjithatë, Fondi për Zhvillim ka rënë viktimë e pengesave politike, më së shumti kufizimeve të importit nga Serbia në Kosovë[14], veçanërisht vendimit të marrë në qershor të vitit 2023 për ndalimin e mallrave të gatshme me origjinë serbe, i cili pati ndikim të dukshëm në të ardhurat e Fondit. Edhe pse Kosova e hoqi ndalimin në pikën kufitare në Merdarë[15] në tetor 2024, si një hap drejt rivendosjes së tregtisë së lirë sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Fondi për Zhvillim financohet vetëm nga të ardhurat doganore të mbledhura në pikat kufitare Jarinjë dhe Bërnjak në veri të Kosovës. Pavarësisht përfitimeve të qarta dhe të prekshme që sjell për të gjitha komunitetet në veri të Kosovës, fati i Fondit është lënë pas dore nga dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës.

[13] https://www.rts.rs/lat/vesti/politika/1252948/osnovan-fond-za-sever-kosova.html
[14] https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/vukadinovic-ogranicenja-za-uvoz-srpske-robe-ostetila-fond-za-razvoj-severa-za-oko-38
[15] https://www.danas.rs/vesti/ekonomija/kurti-o-uvozu-robe-iz-srbije-delimicna-dozvola-uvoza-robe-na-prelazu-merdare-dovoljna-za-ceftu-i-berlinski-proces/

Paralelisht me presionet diplomatike për ringjalljen e tij, duhet të merren në konsideratë përmirësime në funksionimin e tij, duke përfshirë kritere transparente dhe të bazuara në meritë për përzgjedhjen e projekteve, një angazhim më të rregullt dhe aktiv nga Bordi Menaxhues, si dhe transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me operacionet e Fondit. Përveç kësaj, duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi projekteve me potencial gjenerimi të ardhurash dhe të stimulohen komunat për të ngritur fonde për projekte plotësuese me qëllim të maksimizimit të ndikimit të Fondit.

Ripërsëritja e elementëve të regjistrimit të popullsisë në veri të Kosovës dhe përcaktimi i kufijve të Mitrovicës së Veriut dhe Jugut

Shqetësime të ndryshme janë ngritur në lidhje me saktësinë dhe legjitimitetin e procesit të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 në katër komunat veriore[16]; shqetësime që justifikojnë një ripërsëritje të procesit për të zbutur disa nga pasojat e mundshme të thella të zbatimit të rezultateve të paplota të mbledhura deri më sot. Shkalla e bojkotit të serbëve të Kosovës ishte e tillë sa që ka shtrembëruar të dhënat demografike të regjistruara, duke e nën-përfaqësuar kështu në thelb popullsinë serbe në veri, siç ishte rasti me regjistrimin e vitit 2011[17].

Të dhëna të tilla janë të domosdoshme për përcaktimin e ndarjes së burimeve, përfaqësimit politik dhe, në fund të fundit, implementimin e Asociacionit/Bashkësisë të Komunave me Shumicë Serbe (AKSHS), një detyrim i hershëm që rrjedh nga Marrëveshja e Brukselit e vitit 2011. Një nga ndikimet më të thella të zbatimit të regjistrimi të paplotë të popullsisë është zvogëlimi i transfertave buxhetore nga Prishtina në veri[18], gjë që do të çonte në financim të pamjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve për serbet e Kosovës dhe komunitetet e tjera.

Një rezultat i tillë vetëm sa do të përforconte më tej perceptimet e diskriminimit, përjashtimit dhe margjinalizimit, duke i dekurajuar më tej komunitetet lokale për t'u angazhuar me pushtetin e tyre komunal për shkak të pamundësisë për t'iu përgjigjur nevojave dhe shqetësimeve të tyre. Besueshmëria e regjistrimit të popullsisë është gjithashtu imperativ për planifikimin e ofrimit të shërbimeve të ardhshme në fushën e shëndetësisë dhe arsimit, fusha të cilat do të jenë nën fokus intensiv kur themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe të ecën përpara.

Përsëritja e regjistrimit të popullsisë në veri të Kosovës do të kërkonte një fushatë proaktive për informimin e banorëve rreth përfitimeve të regjistrimit të plotë të popullsisë, të kombinuar me lobimin e komunitetit ndërkombëtar në Prishtinë dhe Beograd për të ofruar mbështetje të plotë për procesin. Paralelisht me këtë, është thelbësore të arrihet përparim në ndarjen e qartë të kompetencave komunale ndërmjet Mitrovicës së Veriut dhe asaj të Jugut, gjë që do të siguronte siguri juridike dhe administrative për qytetin dhe banorët e tij, si dhe do të krijonte kushte për një qeverisje lokale më funksionale.

[16] https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/vukadinovic-ogranicenja-za-uvoz-srpske-robe-ostetila-fond-za-razvoj-severa-za-oko-38
[17] https://www.unops.org/kosovo
[18] https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2524

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Dëmi rrënjësor i shkaktuar besimit midis komuniteteve, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështjet e sigurisë dhe qeverisjes, do të duhet kohë për t'u shëruar. Dorëheqja e serbëve të Kosovës në nëntor të vitit 2022 nga pozitat e tyre zyrtare në veri, veçanërisht nga policia, gjyqësori dhe prokuroria, ishte një ngecje e rëndë për procesin e integrimit dhjetëvjeçar, me zhvillimet pasuese që shkatërruan më tej pozicionin e komunitetit serb të Kosovës. Si pasojë e përgjithshme kemi rënien drastike të perceptimeve të sigurisë dhe mbrojtjes në veri të Kosovës, pa shenja se situata do të ndryshojë së shpejti.

Ndikimi në situatën e sigurisë pasqyrohet në dëshmitë e serbëve të Kosovës, ku shumë prej të cilëve kanë përjetuar rënie në realitetin e tyre të sigurisë personale dhe kolektive në vitet e fundit. Një pasojë e situatës në përkeqësim në veri është largimi i serbëve nga Kosova, me një konkluzion tjetër të Analizës së Trendit për vitin 2024 që është se një e treta e të anketuarve do të "largohen nëse shfaqet mundësia"'. Pa ndryshime thelbësore në mënyrën se si qeveriset veriu, si nga Prishtina ashtu edhe nga niveli lokal, shumë serbë të Kosovës do të arrijnë në përfundimin se e ardhmja e tyre është diku tjetër.

Kthimi i serbëve të Kosovës në institucionet e vetëqeverisjes lokale do të ishte një ndryshim i mirëpritur në dinamikën e vëzhguar në disa vitet e fundit. Megjithatë, kjo në vetvete nuk është e mjaftueshme për të siguruar përmirësime pozitive në aspektin e sigurisë dhe qeverisjes.

Për këtë qëllim, propozojmë rekomandimet kyçe për të siguruar riintegrim substancial në veri të Kosovës:

Rekomandime kyçe për bashkësinë ndërkombëtare

1

Të ofrohet mbështetje e ripërtërirë dhe e prekshme për mekanizmat e sigurisë/mbrojtjes në komunitet, veçanërisht aty ku jetojnë serbët e Kosovës, me qëllim të identifikimit dhe zgjidhjes së shqetësimeve specifike përpara se të njëjtat të nxisin tensione lokale.

2

Paralelisht, Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) të jetë më transparent dhe proaktiv në shpjegimin e natyrës së punës së tij monitoruese dhe ndërmarrjen e veprimeve për të korrigjuar mangësitë sistematike, veçanërisht kur bëhet fjalë për ankesat ndaj policisë.

3

Të sigurohen programe që inkurajojnë qasje të orientuara nga partneriteti ndaj pushtetit lokal, si një mjet për të siguruar ofrimin e shërbimeve sociale që i përgjigjet nevojave dhe shqetësimeve të të gjithë banorëve.

4

Të përsëriten thirrjet që Prishtina të ndalojë mbylljen ose pengimin e njëanshëm të institucioneve nga të cilat komuniteti serb i Kosovës varet për ekzistencën e tij të përditshme, me një vijë të qartë të kuqe se statusi i strukturave të mbështetura nga Serbia duhet të zgjidhet përmes negociatave, jo mbylljeve të njëanshme.

5

Të ndërmerren hapa të prekshëm për të rigjallëruar Fondin për Zhvillim si një prioritet i dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës me qëllim të zhbllokimit të investimeve shumë të nevojshme në veri të Kosovës, duke përfshirë edhe bërjen e tij një prioritet për Prishtinën dhe duke propozuar modalitete të reja pune për të forcuar funksionimin e tij.

6

Të krijohet konsensusi në Kosovë, përfshirë edhe midis partive politike të opozitës të cilat mund të formojnë qeverinë e re, në lidhje me nevojën për të ripërsëritur disa elemente të regjistrimit të popullsisë, ndërkohë që të angazhohet diplomatikisht me Beogradin për të siguruar pjesëmarrje substanciale të komunitetit serb në Kosovë.

7

Në të njëjtën kohë, të ritheksohet se rihapja e Urës Kryesore nuk mund të vazhdojë pa një proces konsultimi thelbësor me komunitetin serb të Kosovës për të zbutur shqetësimet që rrjedhin, në veçanti, nga rastet e përsëritura të ngacmimit seksual.

Rekomandime kyçe për akterët vendas

1

Të krijohet një mekanizëm brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme që do të shqyrtonte urgjentisht mundësitë për përmirësimin e mekanizmave të sigurisë në komunitet, me qëllim forcimin e besimit dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe popullsisë lokale, veçanërisht në mjediset e ndjeshme.

2

Të lancohet procesi për adresimin urgjent të problemeve që rrjedhin, në veçanti, nga rastet e përsëritura të ngacmimit seksual në veri të Kosovës, ku organizatave të grave nga Mitrovica e Veriut dhe Mitrovica e Jugut t'u jepet një mandat i qartë dhe i pavarur për të kryer një shqyrtim të detajuar dhe për të propozuar një sërë rekomandimesh të prekshme.

3

Të inkurajohen në mënyrë aktive komunat në krijimin e Grupeve Këshillimore, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, me qëllim të zhvillimit të strategjive dhe planeve të veprimit për ofrimin e shërbimeve sociale, një rrjet mbështetës midis komunave që janë të gatshme të angazhohen në modele të tilla partneriteti.

4

Të zhvillohet një plan se si elementet e regjistrimit të popullsisë në veri të Kosovës mund të përsëriten për të siguruar që numrat pasqyrojnë realitetin demografik në veri, përmes të cilit do të sigurohet ndarja e fondeve të nevojshme buxhetore, duke përfshirë fushatat e informimit publik dhe stafin e mjaftueshëm që flet gjuhën serbe.

5

Të propozohet në mënyrë aktive një qasje pjesëmarrëse e grupit punues për të çuar përpara përcaktimin e kufijve komunalë midis Mitrovicës së Veriut dhe të Jugut me qëllim të ofrimit të sigurisë ligjore dhe administrative për të gjithë.